

# Bienvenue



## MIRË SE VINI!

En France, **l'école publique est gratuite et l'instruction est obligatoire** pour les filles et les garçons âgés de 6 à 16 ans. Le parcours de l'élève peut commencer à 3 ans (voire 2 ans dans la limite des places disponibles) et peut se poursuivre au-delà de 16 ans.

Aller à l'école est **un droit** pour tous les enfants français et étrangers qui vivent en France.

**L'école respecte et enseigne les valeurs de la République française** : tous les enfants sont accueillis et respectés quels que soient leur origine, leur nationalité, leur religion, leur sexe, leur statut familial, leur handicap. Les garçons et les filles étudient dans les mêmes classes et sont traités à égalité.

**L'école publique est laïque** : elle respecte les cultures, les langues et la religion de chacun. Ni les enfants, ni les adultes ne peuvent promouvoir à l'école, sous aucune forme, leur confession religieuse et/ou leurs opinions politiques.

**À l'école, votre enfant apprend la langue française.** Parler français est une nécessité car le français est la langue de la République. À l'école, c'est en français que votre enfant apprend à parler, lire, écrire, compter. Cependant, il est important pour lui de continuer à parler dans sa langue d'origine.

À l'école, les enfants apprennent **à vivre ensemble**, à mieux se connaître, à partager leurs cultures.



Në Francë, **shkolla publike është falas dhe arsimi është i detyruar** për vajzat dhe djemtë nga moshë 6 deri në 16 vjeç. Një nxënës mund të fillojë shkollën në moshën 3 vjeç (ndonjëherë edhe në moshën 2 vjeç, nëse ka vende të lira) dhe mund ta vijojë atë përtej moshës 16 vjeç.



Të shkuarit në shkollë është një **e drejtë ligjore** për të gjithë fëmijët francezë dhe të huaj që jetojnë në Francë.

**Shkolla respekton fëmijët dhe u mëson atyre vlerat e Republikës franceze**: të gjithë fëmijët pranohen dhe respektohen pavarësisht origjinës, kombësisë, fesë, seksit dhe statusit të tyre familjar apo ndonjë paaftësie që ata mund të kenë. Djemtë dhe vajzat mësojnë në të njëjtat klasa dhe trajtohen në mënyrë të barabartë.

**Shkolla publike është laike**: ajo respekton kulturat, gjuhët dhe fenë e secilit. Asnjë fëmijë ose të rrituri nuk i lejohet, në asnjë mënyrë dhe formë, të promovojë në shkollë bindjet e tij fetare dhe/ose opinionet e tij politike.

**Në shkollë, fëmija juaj mëson gjuhën franceze.** Është e nevojshme të komunikosh frëngjisht, sepse frëngjishtja është gjuha e Republikës. Në shkollë, frëngjishtja i mëson fëmijës të flasë, të lexojë, të shkruajë, të përlllogarisë. Megjithatë, për fëmijën është e rëndësishme që ai të vazhdojë të përdorë edhe gjuhën e tij të origjinës.

Në shkollë, fëmijët mësojnë **të jetojnë së bashku**, të njihen më mirë me njëri-tjetrin dhe të shkëmbejnë kulturat e tyre.



## L'école française

En France, la scolarisation des enfants est organisée en fonction de leur âge.

De 3 ans (parfois 2) jusqu'à 6 ans, l'enfant peut être accueilli à **l'école maternelle**, facultative et gratuite. L'école maternelle est organisée en 3 niveaux : petite, moyenne et grande sections. Elle est le lieu des premiers apprentissages qui favorisent la réussite scolaire.

**L'école élémentaire** accueille les enfants de 6 à 11 ans. Elle comporte cinq niveaux : le CP (cours préparatoire), le CE1 (cours élémentaire 1<sup>re</sup> année), le CE2 (cours élémentaire 2<sup>e</sup> année), le CM1 (cours moyen 1<sup>re</sup> année) et le CM2 (cours moyen 2<sup>e</sup> année).

**Le collège** accueille tous les élèves après l'école élémentaire. Il est organisé en quatre niveaux : la 6<sup>e</sup> (sixième), la 5<sup>e</sup> (cinquième), la 4<sup>e</sup> (quatrième) et la 3<sup>e</sup> (troisième).

**Le lycée** accueille les élèves qui poursuivent des études générales, technologiques ou professionnelles après le collège.

### Comment votre enfant apprend-il le français ?

Tous les adultes de l'école sont attentifs à aider votre enfant dans l'apprentissage de la langue française.

À l'école élémentaire, au collège ou au lycée, votre enfant est inscrit dans une classe ordinaire et bénéficie d'un enseignement spécifique de français pour quelques heures dans la semaine avec des élèves nouveaux arrivants de sa classe et d'autres classes ; dans certains établissements scolaires, il est inscrit dans une classe spécifique avec d'autres élèves nouveaux arrivants pour apprendre le français.

De votre côté, vous pouvez aider votre enfant à apprendre plus vite le français en l'inscrivant à des activités sportives, culturelles ou sociales dans le quartier.

Une bonne maîtrise de la langue française orale et écrite est indispensable à votre enfant pour réussir sa scolarité, poursuivre sa formation, construire son avenir professionnel et réussir sa vie en société.

## Sistemi arsimor francez

Në Francë, shkollimi i fëmijëve organizohet në bazë grup-moshash.

Nga mosha 3 vjeç (ndonjëherë 2) deri në 6 vjeç, fëmija mund të regjistrohet **në kopësht (l'école maternelle)**, i cili është falas, por jo i detyruar (fakultativ). Kopshti organizohet në tri nivele sipas grup-moshës së fëmijës: i ulët, i mesëm dhe i lartë. Në kopsht, fëmijët hedhin bazat për suksesin e tyre të mëtejshëm shkollor.

**Shkolla fillore (l'école élémentaire)** pranon fëmijët e moshës 6 deri më 11 vjeç. Ajo përmban 5 nivele: CP (niveli përgatitor), CE1 (niveli filleshtar, viti i parë), CE2 (niveli fillestar viti i dytë), CM1 (niveli i ndërmjetëm, viti i parë) dhe CM2 (niveli i ndërmjetëm, viti i dytë).

**Arsimi i mesëm i ulët ose kolegji (le collège)** pranon të gjithë fëmijët që mbarojnë shkollën fillore. Ai organizohet në 4 nivele: e 6-ta, e 5-ta, e 4-ta dhe e 3-ta.

**Shkolla e mesme (le lycée)** pranon nxënësit që mbarojnë kolegjin dhe duan të vazhdojnë studimet në drejtimet: e përgjithshme, teknologjike dhe profesionale.

### Si do të mësojë frëngjisht fëmija juaj?

Shkolla do ta ndihmojë fëmijën tuaj të mësojë frëngjisht.



Në shkollën fillore, në kolegji dhe në shkollën e mesme, fëmija juaj regjistrohet në një klasë të zakonshme dhe do të marrë mësim të veçanta në gjuhën frënge, disa orë në javë, së bashku me nxënësit e tjerë të rinj, të klasës së tij ose klasave të tjera. Në disa shkolla, fëmija regjistrohet në një klasë të veçantë me fëmijë të tjerë, për të mësuar gjuhën frënge.

Ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj të mësojë gjuhën frënge më shpejt duke e përfshirë atë në veprimtari sportive, kulturore ose sociale që organizohen në lagjen tuaj të banimit.

Një nivel i mirë i gjuhës frënge është absolutisht thelbësor për fëmijën tuaj që ai të arrijë suksese në shkollë, të përmbushë formimin e tij, të ndërtojë karrierën për të ardhmen dhe të jetë i suksesshëm në jetë.

## Votre enfant entre à l'école maternelle

Une fréquentation régulière de l'école maternelle permet à votre enfant de bien engager son apprentissage de la langue française : **la maîtrise de la langue française est absolument nécessaire à la réussite de sa scolarité.**

À l'école maternelle, votre enfant apprend à parler avec les adultes et avec les autres enfants. Il dessine, chante, danse, joue, compte, parle, écoute, invente... et commence à écrire.

Votre enfant découvre les livres et l'écriture, il se prépare à entrer à l'école élémentaire.

Votre enfant apprend aussi à vivre avec les adultes et les autres enfants de son âge en respectant les règles de l'école.

À l'école maternelle, vous accompagnez et venez chercher votre enfant aux horaires fixés. C'est un moment privilégié pour rencontrer les maîtres et d'autres parents. Si vous ne pouvez pas venir chercher votre enfant à l'école, il peut être confié à un autre adulte à condition que vous en donniez l'autorisation écrite.

Les récréations sont des moments de pause entre les activités. Elles se déroulent dans la cour sous la surveillance des enseignants. Elles favorisent l'activité physique et les échanges entre enfants d'âges différents.

Le midi, votre enfant a la possibilité de déjeuner à l'école : les repas sont équilibrés. Ils respectent les règles alimentaires et, à la demande des parents et dans la mesure du possible, les règles religieuses.

Votre enfant peut se reposer l'après-midi dans un lieu spécialement aménagé et surveillé.

Vous pouvez demander à rencontrer le maître ou la maîtresse de votre enfant ou encore le directeur ou la directrice de l'école maternelle.



## Fillimi i kopshtit

Ndjekja rregullisht e kopshtit e ndihmon fëmijën tuaj të hedhë hapat e parë në mësimin e gjuhës frënge: **zotërimi i gjuhës frënge është absolutisht i domosdoshëm që fëmija juaj të ketë sukses në shkollë.**

Në kopsht, fëmija do të mësojë si të flasë me fëmijët e tjerë dhe me të rriturit. Ai do të mësojë të vizatojë, të këndojë, të vallëzojë, të luajë, të numërojë, të bisedojë, të krijojë... dhe të fillojë të shkruajë.

Fëmija do të fillojë të hyjë në botën e librave dhe në atë të të shkruarit, duke u përgatitur kështu për në shkollën fillore.

Gjithashtu, fëmija juaj do të mësojë si të jetojë me moshatarët e tij dhe me të rriturit, si dhe të respektojë rregullat dhe rregulloret e shkollës.

Në kopsht, ju e shoqëroni fëmijën tuaj dhe mund ta kërkoni atë në oraret e përcaktuara. Shoqërimi i fëmijës për në kopsht, ju jep mundësinë të takoni prindërit e tjerë dhe mësuesit. Nëse nuk keni mundësi ta merrni fëmijën tuaj nga kopshti, një person tjetër madhor, i autorizuar me shkrim prej jush, mund të kujdeset për të.

Pushimet midis orëve mësimore/veprimtarive janë periudhat e çlodhjes për fëmijët. Ato organizohen në oborrin e kopshtit nën vëzhgimin e mësuesit. Veprimtaritë çlodhëse ndikojnë në zhvillimin fizik të fëmijës dhe mundësojnë ndërveprimin e fëmijëve me njëri-tjetrin.

Në kopsht, fëmija juaj ka mundësi të drekojë. Vaktet janë të mirëbalancuara, respektojnë udhëzimet për ushqimin dhe, sipas kërkesës së prindërve, përshtaten me traditat fetare të të ushqyerit.

Fëmija juaj mund të çlodhet pasdite në një mjedis të posaçëm në kopsht.

Ju mund të kërkoni takim me mësuesin/en e fëmijës suaj apo edhe me drejtuesin e kopshtit.



## • Votre enfant entre à l'école élémentaire

L'école élémentaire est organisée en cinq classes en fonction de l'âge des enfants : le cours préparatoire (CP) de 6 à 7 ans ; les cours élémentaires première et deuxième année (CE1, de 7 à 8 ans et CE2, de 8 à 9 ans), les cours moyens première et deuxième année (CM1 de 9 à 10 ans et CM2 de 10 à 11 ans).

Chaque classe est placée **sous la responsabilité d'un maître** avec qui vous pouvez parler en toute confiance. N'hésitez pas à lui poser les questions qui vous paraissent importantes. Vous êtes régulièrement informé des progrès de votre enfant ou de ses difficultés grâce à un livret scolaire.

À l'école élémentaire, chaque absence ou retard doit être justifié et les horaires doivent être respectés.

À l'école élémentaire, votre enfant apprend à lire, à écrire et à compter, il étudie aussi les sciences, la technologie, l'histoire et la géographie, il fait de la musique, du sport ; il va à la piscine. Il utilise un ordinateur. Toutes ces activités sont importantes pour son développement. Elles sont obligatoires.

Pour votre enfant, **la priorité est la maîtrise du français** qui va lui permettre d'apprendre dans toutes les disciplines. Tous les adultes de l'école sont attentifs à l'aider à maîtriser la langue française. De votre côté, vous pouvez y contribuer en l'inscrivant à des activités sportives, culturelles ou sociales dans le quartier.

**Le socle commun de connaissances et de compétences** rassemble les connaissances, compétences, valeurs et attitudes qui sont nécessaires à votre enfant pour réussir sa scolarité, sa vie d'individu et de futur citoyen.

**Un livret personnel de compétences** permet de suivre la progression de chaque élève.

Des évaluations des connaissances et des compétences des élèves ont lieu au début du CE1 et du CM2.

Votre enfant pourra bénéficier d'heures **d'accompagnement personnalisé** pour progresser dans ses apprentissages, notamment de la langue française. **Des stages de remise à niveau** peuvent être également proposés à votre enfant : une semaine pendant les vacances scolaires.

Le soir à la maison, demandez à votre enfant ce qu'il a fait à l'école, ce qu'il a appris, ce qu'il va faire le lendemain ; parlez avec lui.

**Rassurez votre enfant** : soyez attentif à ce qu'il apprend, à ce qu'il dit de ce qui se passe dans de cette nouvelle école, dans ce nouveau pays.

Vous pouvez rencontrer le maître de votre enfant ou le directeur de l'école primaire.

## Fillimi i shkollës fillore

**Shkolla fillore** organizohet në pesë klasa sipas moshës së fëmijës.: klasa përgatitore (CP) nga moshë 6 deri në 7 vjeç; klasat fillestare viti i parë dhe i dytë (CE1 nga moshë 7 deri në 8 vjeç dhe CE2 nga moshë 8 deri në 9 vjeç), klasat e ndërmjetme viti i parë dhe i dytë (CM1 nga moshë 9 deri në 10 vjeç dhe CM2 nga moshë 10 deri në 11 vjeç).

Cdo klasë ka në dispozicion një **mësues përgjegjës** me të cilin mund të flisni me besim më të plotë. Mos hezitoni t'i bëni atij pyetjet që u duken të rëndësishme. Ju informoheni për ecurinë dhe progresin e fëmijës tuaj si dhe për vështirësitë e tij përmes një evidence shkollë ("livret scolaire").

**Në shkollën fillore**, çdo mungesë apo vonesë duhet të jetë e justifikuar dhe oraret duhet të respektohen.

**Në shkollën fillore**, fëmija juaj mëson të lexojë, të shkruajë dhe të përllorarisë. Ai studion gjithashtu shkencat, teknologjinë, historinë dhe gjeografinë. Ai bën muzikë dhe sport. Fëmija shkon në pishinë. Ai përdor kompjuterin. Të gjitha këto veprimtari janë të rëndësishme për zhvillimin e tij. Ato janë të detyrueshme.

**Zotërimi i gjuhës frënge nga fëmija juaj, konsiderohet si një prioritet** pasi ajo i mundëson atij të mësuarin e të gjitha lëndëve të tjera. Të gjithë të rriturit në shkollë tregojnë kujdes dhe ndihmojnë fëmijën për zotërimin e gjuhës frënge. Nga ana juaj, ju mund të kontribuoni duke e regjistruar fëmijën në aktivitete sportive, kulturore dhe sociale që organizohen në lagjen tuaj të banimit.

Njohuritë dhe kompetencat e përbashkëta i japin fëmijës tuaj njohuri, kompetenca, vlera dhe qëndrime, të cilat janë të rëndësishme për të në realizimin e arritjeve në shkollë, në jetën e tij personale të qytetarit të ardhshëm.

**Evidenca individuale e kompetencave** ju mundëson të ndiqni progresin e çdo nxënësi.

Provime për njohuritë dhe kompetencat e nxënësve zhvillohen në CE1 dhe CE2.

Fëmija juaj mund të përftojë edhe nga **orë suplementare të personalizuar** nga të cilat ai përparon në mësimin sidomos në gjuhën frënge. Fëmijës tuaj i propozohen kurse për përmirësimin e nivelit: një javë gjatë pushimeve verore.

Në shtëpi, në mbrëmje, pyeteni fëmijën tuaj se çfarë ka bërë në shkollë, çfarë ka mësuar dhe çfarë duhet të përgatisë për të nesërmen; komunikoni me të.

**Mbështeteni fëmijën tuaj**: tregoni kujdes për çfarë ai mëson, çfarë ai tregon për shkollën e tij të re, në këtë vend të ri.

Ju mund të takoni mësuesin e fëmijës tuaj ose drejtorin e shkollës fillore.



## Votre enfant entre au collège



La personne qui dirige le collège est **le principal**, que vous pouvez demander à rencontrer. Il est en général aidé d'un adjoint.

Le collège est organisé en quatre niveaux : la 6<sup>e</sup>, la 5<sup>e</sup> et la 4<sup>e</sup>, la 3<sup>e</sup>.

Au collège, votre enfant étudie avec plusieurs professeurs ; chacun est spécialiste d'une discipline.

**Le professeur principal et le conseiller principal d'éducation (CPE)** sont vos premiers interlocuteurs : n'hésitez pas à demander à les rencontrer pour savoir si tout se passe bien en classe et dans le collège pour votre enfant.

Vous êtes régulièrement informé du travail de votre enfant grâce au **cahier de correspondance**, au **bulletin scolaire trimestriel** et aux **réunions qui réunissent professeurs et parents**.

Au collège, votre enfant acquiert beaucoup de connaissances dans de nombreux domaines : français, mathématiques, sciences, technologie, histoire, géographie, sport, musique, langue étrangère... Il utilise un ordinateur.

Votre enfant doit maîtriser la langue française pour pouvoir étudier dans toutes les autres disciplines. Tous les professeurs de sa classe sont attentifs à faciliter son apprentissage. De votre côté, vous pouvez y contribuer en l'inscrivant à des activités sportives, culturelles ou sociales dans le quartier.

Votre enfant a besoin de temps pour se familiariser avec le français oral et écrit.

**Une aide individualisée** peut être organisée pour aider votre enfant en français ou dans les autres apprentissages, à raison de deux heures par semaine ; **de l'aide aux devoirs** peut également lui être proposée. Enfin, **un projet personnalisé de réussite éducative** peut être convenu entre vous, votre enfant et l'équipe éducative.

La dernière année du collège, les élèves passent un examen national : **le diplôme national du brevet (DNB)** et doivent valider les sept grandes compétences du socle commun de connaissances et de compétences.

Au collège, votre enfant apprend à devenir plus autonome dans son travail : vous pouvez l'aider à le devenir : vérifiez avec lui s'il n'a pas un travail à faire pour le lendemain ou les jours suivants ou bien un document à vous remettre.

Lorsqu'il rentre le soir, demandez-lui ce qu'il a fait dans la journée et ce qu'il a appris. Parlez avec lui. Manifestez votre intérêt pour sa scolarité.

À l'issue de la classe de 3<sup>e</sup>, **une procédure d'orientation** permettra à votre enfant, en fonction de ses compétences, de ses souhaits et des vœux de ses parents, de poursuivre des études **en lycée professionnel ou en lycée général ou technologique**, ou encore de fréquenter **un centre de formation pour apprentis (CFA)**.

## Fillimi i arsimit të mesëm të ulët ose kolegjit

Arsimi i mesëm i ulët ose kolegji (le collège) drejtohet nga **drejtori**, të cilin ju edhe mund të kërkonit që ta takoni. Zakonisht, drejtori ndihmohet nga një nëndrejtor.

Kolegji pranon të gjithë fëmijët që mbarojnë shkollën fillore. Ai organizohet në 4 nivele: e 6-ta, e 5-ta, e 4-ta dhe e 3-ta.

Në kolegji, fëmijës suaj i japin mësim disa mësues; secili prej tyre është i profilizuar në një lëndë të caktuar.

Mësuesi kujdestar dhe këshilluesi pedagogjik janë bashkëbiseduesit tuaj: mos hezitoni të kërkonit takim me ta për të mësuar si përparon fëmija juaj në klasë dhe në shkollë.

Ju informoheni për ecurinë e fëmijës suaj përmes **fletores së shënimeve, buletinit shkollor semestral dhe takimeve me prindër**.

Në kolegji, fëmija juaj fiton njohuri në disa fusha: frëngjisht, matematikë, shkenca, teknologji, histori, gjeografi, sport, muzikë, gjuhë e huaj... ai përdor dhe kompjuterin.

Fëmija juaj duhet të zotërojë gjuhën frënge për të bërë të mundur studimin e të gjitha lëndëve të tjera. Të gjithë mësuesit e ndihmojnë fëmijën për të mësuar gjuhën frënge. Nga ana tjetër, ju gjithashtu mund të kontribuoni që fëmija të mësojë lehtësisht frëngjishten duke e regjistruar atë në veprimtari sportive, kulturore dhe sociale të lagjes.

Fëmijës suaj i nevojitet koha e duhur për t'u familjarizuar me të folurin dhe të shkruarin e gjuhës frënge.

Për të ndihmuar fëmijën tuaj në gjuhën frënge dhe në lëndë të tjera, mund të organizohet **përkujdesje individuale**, deri në dy orë në javë, si dhe mund t'i ofrohet atij edhe **ndihmë për detyrat e shtëpisë**. Së fundmi, **një plan i arritjeve personale** mund të hartohet dhe të zbatohet nga stafi mësimdhënës me pëlqimin tuaj dhe në bashkëpunim me ju dhe me fëmijën tuaj.

Vitin e fundit të kolegjit, nxënësit i nënshtrohen një provimi kombëtar DNB (provimi i lirit në Shqipëri) ku ata provojnë shtatë aftësitë kryesore sipas kuadrit të përbashkët të njohurive dhe aftësive.

Në kolegji, fëmija juaj mëson si të jetë sa më i pavarur në punën e tij; ju mund ta ndihmoni fëmijën të bëhet i pavarur: shiko dhe kontrollo nëse fëmija juaj ka bërë detyrat për ditën e nesërme dhe për ditët në vijim. Gjithashtu, kërko nëse ka për t'ju dhënë ndonjë dokument.

Kur fëmija kthehet në shtëpi pas shkolle, pyeteni atë se çfarë bëri gjatë ditës dhe çfarë mësoi. Bisedoni me të. Tregoni interes për punën e tij/ saj në shkollë.

Në përfundim të klasës së 3-të, **procedura e orientimit për karrierë** do t'i mundësojë fëmijës suaj, në varësi të aftësive të tij, ambicies dhe këshillave të prindërve, të shkojë në një gjimnaz, në **një shkollë të mesme profesionale apo teknike**, ose të ndjekë një **qendër të formimit profesional**.

# Votre fille ou votre fils entre au lycée

La personne qui dirige le lycée est **le proviseur**. Il est aidé d'un proviseur-adjoint : vous pouvez demander à les rencontrer.

En France, il existe deux types de lycées :

**Le lycée d'enseignement général et technologique** prépare les élèves à la poursuite d'études supérieures. Il s'organise en trois niveaux : la classe de seconde générale et technologique, qui est une classe de détermination, puis le cycle terminal composé des classes de première et de terminale.

Le cycle terminal de la voie générale est organisé en trois séries : une série littéraire (série L dans laquelle les enseignements littéraires, artistiques ou linguistiques ont une importance particulière), une série scientifique (série S avec un volume horaire important en mathématiques, en physique-chimie et en sciences et vie de la terre), une série économique et sociale (série ES).

Après la classe de seconde générale et technologique, les élèves peuvent également s'orienter vers le cycle terminal de la voie technologique. Cette voie mène traditionnellement vers des études supérieures plus courtes.

La voie technologique est organisée en huit séries portant chacune sur des domaines de connaissances et d'activités très variés : management et gestion (série STMG), design et arts appliqués (série STD2A), industries et développement durable (série STI2D), hôtellerie et restauration (STHR), sciences et technologies de laboratoire (série STL), sciences et technologies de la santé et du social (ST2S), agronomie (série STAV), techniques de la musique et de la danse (série TMD).

À la fin du cycle terminal, les élèves s'inscrivent à un examen. En cas de réussite à cet examen, ils se voient délivrer le diplôme du baccalauréat qui non seulement sanctionne la fin des études secondaires mais est également le premier grade universitaire.

**Le lycée professionnel** prépare les élèves à une insertion plus rapide dans le monde du travail ; certains élèves peuvent cependant poursuivre des études supérieures. Plusieurs diplômes peuvent être préparés, du CAP au baccalauréat professionnel. Les élèves suivent à la fois des enseignements généraux et des enseignements technologiques et professionnels.

Des stages obligatoires ont lieu en entreprise.

Dans l'emploi du temps de la classe, **deux heures d'accompagnement personnalisé** sont prévues pour aider les élèves à progresser dans les disciplines où ils rencontrent des difficultés ou à acquérir des méthodes de travail. Grâce à ces deux heures, votre enfant pourra progresser dans la maîtrise de la langue française.

**Au lycée**, les élèves bénéficient d'une grande autonomie. Pour réussir, ils doivent fournir un travail important à la maison. Assurez-vous que votre enfant comprend bien en classe ce qu'il doit faire.

Vous pouvez prendre rendez-vous avec le professeur principal, si vous ou votre enfant êtes inquiets.

**Au lycée, la procédure d'orientation** est très importante. Votre enfant devra décider s'il souhaite effectuer des études supérieures ou entrer directement dans le monde du travail. Ses professeurs l'aideront dans ce choix.

## Fillimi i shkollës së mesme

Shkolla e mesme (le lycée) drejtohet nga drejtori (le proviseur), i cili ndihmohet nga një nëndrejtor (le proviseur-adjoint). Ju mund të kërkonti t'i takoni ata.

Në Francë ka dy lloje shkollash të mesme:

**Shkolla e mesme e përgjithshme dhe teknologjike** i përgatit nxënësit për të ndjekur arsimin e mesëm të lartë. Shkolla e mesme organizohet në tri nivele (klasa): niveli i dytë i përgjithshëm dhe teknologjik që është një nivel vendimtar i përbashkët. Pas këtij niveli, nxënësi ka mundësi të ndjekë nivelin përfundimtar që përbëhet nga dy klasa shkollore; klasa e parë dhe ajo përfundimtare. Niveli përfundimtar organizohet në dy drejtime: niveli përfundimtar i përgjithshëm dhe niveli përfundimtar teknologjik. Niveli përfundimtar i përgjithshëm organizohet në tri seri :gjuhësore (seria L në të cilën lëndët letrare, artistike apo gjuhësore kanë një rëndësi të veçantë); shkencore (seria S ku vendin kryesor në volumin sipas orëve e zënë matematika, fizika, kimia, shkencat dhe jeta në tokë) dhe seria ekonomike dhe sociale (seria ES). Niveli përfundimtar me drejtim teknologjik çon në studime më të shkurtra.

Niveli përfundimtar me drejtim teknologjik organizohet në tetë seri, secila duke mbuluar një gamë të gjerë të njohurive dhe aktiviteteve si menaxhim dhe administrim (e quajtur seria STMG), dizajn dhe artet e aplikuar (seria STD2A), industritë dhe zhvillimi i qëndrueshëm (seria STI2D), hotelieri (STHR), shkencat dhe teknologjitë laboratorike (seria STL), shkencat dhe teknologjitë e shëndetit dhe ato sociale (ST2S), agronomi (seria STAV), teknikat muzikore dhe kërcimit (seria TMD).

Në përfundim të nivelit përfundimtar, nxënësit regjistrohen për të dhënë një provim. Në rast të marrjes me sukses të këtij provimi, nxënësi pajiset me diplomën e shkollës së mesme të pjekurisë (le baccalaureat), me anë të së cilës sanksionohet jo vetëm përfundimi i studimeve në shkollën e mesme por konsiderohet edhe si niveli i parë fillestar universitar.

**Shkolla e mesme profesionale** i edukon dhe i aftëson nxënësit për t'u integruar më shpejt për punë. Sidoqoftë, nxënësi mund të zgjedhë të ndjekë studimet në arsimin e lartë. Në përfundim të shkollës profesionale, lëshohen këto lloje diplomash: CAP (diplomë e aftësisë profesionale - niveli I sipas të kuadrit të kualifikimeve profesionale deri në "Baccalaureat profesional" që korrespondon me nivelin II të kuadrit të kualifikimeve profesionale. Nxënësit marrin trajnim të përgjithshëm, teknik dhe profesional. Praktika profesionale është pjesë e detyrueshme e procesit mësimor.

Plani mësimor ka edhe **dy orë për këshillim individual** për të ndihmuar nxënësit të mësojnë më mirë, të kalojnë vështirësitë dhe të zotërojnë metoda pune. Falë këtyre dy orëve, fëmija juaj do të ketë mundësi të përmirësojë gjuhën frënge.



**Në shkollën e mesme**, nxënësit janë më të pavarur për të qenë të suksesshëm. Ata duhet të përgatiten shumë në shtëpi. Sigurohuni që fëmija juaj e ka të qartë se çfarë pritet prej tij.

Mos hezitoni të takoni drejtorin apo mësuesin kujdestar, nëse fëmija juaj ka ndonjë shqetësim.

**Në shkollën e mesme, procedura e orientimit, këshillimit për karrierën** është me të vërtetë e rëndësishme. Fëmija juaj duhet të vendosë nëse dëshiron të vazhdojë arsimin e lartë apo të hyjë në tregun e punës. Mësuesit do ta ndihmojnë fëmijën tuaj që të bëjë zgjedhjen.